



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

Data	24.07/20	Vendi	Kaçanik
Org.	Numri	Shtojcë	
01 Nr.	60/01-15704	120	

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së V-të (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 21 Korrik 2020.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e V-të (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 21 Korrik 2020, dhe atë:

1. Vendim për Raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019/
Lënda: 01Nr. 60/01-15000/20;
2. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës
29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të
paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.07-104/02-
15302/20;
3. Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të
Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën pusët, rezervuarët e ujit, stacionet e
pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të
KRU" Bifurkacioni" SHA Ferizaj / Lënda: 01Nr.07-104/02-15307/20;
4. Vendimi për anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 të datës
27.05.2020- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore/
Lënda: 01Nr. 350/02-16206/20; dhe
5. Deklaratë për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës/
Lënda: 01Nr. 60/01-15987/20.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të
ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-15000/20

Kaçanik: 21.07.2020

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 21 Korrik 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME
PUBLIKE PËR VITIN 2019

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-15000/20 - me tekstin e mëtejshëm "Raporti Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019".
2. Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi përmban, aktivitetin e Komitetit për Shërbime Publike të zhvilluar për gjatë vitit 2019 në takime të rregullta dhe temat e debatuar në këto takime, që bien në kompetencë të këtij komiteti.
3. Raporti është përmbledhur në gjithsej 2 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Shërbime Publike dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK	
Data	08.07.20	Vendi KAÇANIK
W.org.	Nuhri	Shtojcë
01	60/01-15000	✓

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE PËR VITIN 2019

Kaçanik, Qershor 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

HYRJE

Komiteti për shërbime publike është formuar me vendim të Kuvendit të Komunës të datës 27.4.2018 në përbërje prej 5 anëtarëve, me përbërje si vijonë:

1. Hamid GuriPDK
2. Lirije Shurdhani DemaPDK
3. Adnan RekaLVV
4. Arlinda Rakoci RakaLDK
5. Afërdita Shehu HoruniAAK

Përbërja e komitetit për shërbime publike, reflekton përfaqësimin e entiteteve politike dhe përfaqësimin e kuotës gjinore të përfaqësuar në Kuvendin Komunal.

RAPORTI I KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE PËR VITIN 2019

Ky raport ka për qëllim informimin sa më objektiv lidhur me ecurinë e punës së këtij komiteti, ky komitet gjatë vitit 2019 ka të parapara gjashtë takime. Në këto takime u diskutuan këto tema:

1. Në takimin e parë të KSHP-së të mbajtur me datën 20.02.2019 u diskutuan këto pika.
 - Raporti i punës së drejtorisë për emergjenca dhe shërbime publike.
 - Informatë për sektortin e emergjencave.
2. Në takimin e dytë të mbajtur me datë 24.04.2019 diskutuam këto pika:
 - Informatë për financimin e shërbimit të vorrimit.
 - Informatë për menagjimin e mbeturinave.
3. Në takimin e tretë të mbajtur me datë 26.07.2019 u diskutuan këto pika:
 - Raporti i punës së kompanisë publike regjionale Pastërtia njësia Kaçanik.
 - Raporti i punës së kompanisë publike regjionale Bifurkacioni njësia Kaçanik.
 - Informate për shërbimet e inspektionit komunal.
 - Informatë për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Kaçanikut.
4. Takimi i katërt u mbajtë me datën 14.11.2019 me këto pika:
 - Informatë për gjendjen me furnizim me ujë të pijës.
 - Informatë për ndriqimin publikë.
5. Takimi i fundit i KSHP-së u mbajtë me datë 26.12.2019 me këto pika:
 - Informatë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale.
 - Hartimi i planit të punës për vitin 2020.

Kaçanik
Qershorë 2020

Kryesuesi i KSHP-së:
Hamid Guri





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.07-104/02-15307/20
Kaçanik, 21.07.2020

Në bazë të nenit 12.2 lidhur me nenit 14 lidhur me nenin 170f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/4 Qershor 2008), të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.07-104/02-39515/19-Për Ndryshimin e Statusit të KRU "Bifurkacioni" nga Ndërmarrja Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore të datës 16.12.2019, të Kërkesës së Sekretarit të KRU "Bifurkacioni" "SHA Ferizaj 01Nr.104/02-12028/20 të datës 12.06.2020, si dhe nenit 6 pika 2 (f) dhe (h) e Statutit të Komunës Nr. 3588/2008 i datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 21 Korrik 2020 mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR IDENTIFIKIMIN E PARCELAVE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT, NË TË CILAT NDODHEN Puset, REZERVOARET E UJIT, STACIONET E POMPIMIT, UJËMBLEDHËSIT DHE OBJEKTET TJERA INFRASTRUKTURE TË CILAT JANË ASETET E KRU "BIFURKACIONI" SHA FERIZAJ

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj, në përbërje prej tre (3) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Visar Mulaku, Zyrtar në DUKMM;
 - 1.2 Naim Luzha, KRU "Bifurkacioni-Njësia Operative Kaçanik; dhe
 - 1.3 Besnik Salihu, Anëtar i Kuvendit të Komunës nga LDK.
2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e këtij Komisioni janë: identifikimi i parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj.
3. Mandati i anëtarëve të komisionit mbaron me përfundimin e detyrave të caktuara si në pikën e 2 të këtij vendimi, respektivisht pas raportimit në organet relevante të komunës (DSHPE dhe DUKMM).
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit;
2. Kryetari i Komunës;
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, -përmes kësaj drejtorie njoftohet KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj;
4. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; dhe
5. Arkivi



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATE/A:	07 104/02-1307 10. 07. 2020
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Besim ILAZI, kryetar i komunës
NGA/OD/FROM :	Ramadush OSMANI, drejtor i DSHPE-së
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim -Vendim për formimin e Komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen pusët, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj

I nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë **"Propozim -Vendim**
për formimin e Komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së
Kaçanikut, në të cilat ndodhen pusët, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit,
ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU
"Bifurkacioni" SHA Ferizaj" për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe
Financa dhe procedim të mëtuqjeshëm si pikë e rendit të ditës në kuvendin komunal.

Të bashkëngjitur shkresës keni:

- **Propozim -Vendimin për formimin e Komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen pusët, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj"** dhe
- Kërkesën me nr. 01-104/02-12028 të datës 09.06.2020 të KRU "Bifurkacioni"-sh.a Ferizaj**

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Në mbështetje të nenit 58 pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 pika f) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut:

Propozon

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.07-104/02-39515/19 Për Ndryshimin e Statusit të KRU "Bifurkacioni" nga Ndërmarrja Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore, të datës 16.12.2019 dhe në bazë të Kërkesës nga Sekretari i KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj 01Nr.104/02-12028/20, të datës 12.06.2020, që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e radhës, më datë _____ të merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR IDENTIFIKIMIN E PARCELAVE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT, NË TË CILAT NDODHEN Puset, REZERVOARET E UJIT, STACIONET E POMPIMIT, UJËMBLEDHËSIT DHE OBJEKTET TJERA INFRASTRUKTURE TË CILAT JANË ASETË TË KRU "BIFURKACIONI" SHA FERIZAJ

1.Me këtë Vendim formohet Komisioni për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen puset, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj, në përbërje prej 3(tre) anëtarëve, siç vijon:

- 1.1 Visar Mulaku-zyrtar në DUKMM
- 1.2 Naim Luzha-KRU "Bifurkacioni"-Njësia Operative Kaçanik
- 1.3 _____-anëtar i Kuvendit Komunal

2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e këtij Komisioni janë identifikimi i parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen puset, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU "Bifurkacioni" SHA Ferizaj.

3.Mandati i anëtarëve të komisionit mbaron me përfundimin e detyrave të caktuara si në pikën e dytë të këtij vendimi.

4.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria e Kadastrit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

5.Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

6. Me këtë vendim njoftohen:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
- KRU “Bifurkacioni” SHA Ferizaj
- Drejtoria e Kadastrit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Arkivi



Kryetari i Komunës së Kaçanikut
Z. Besim Ilazi



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY

BIFURKACIONI SHA

Ferizaj

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAÇANIK		
Data: 12.06.2020	Vendi: KAÇANIK	
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01-104/02-12028-1		



Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel. & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

Data: 09.06.2020
Për: Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Nga: Besnik Aliu, Sekretar i KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj
Lënda: Kërkesë

KRU Bifurkacioni, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me nr. protokoli 01Nr.07-104/02-39515/19 të datës 27.12.2019, për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni, nga Ndërmarrje Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore, paraqet këtë:

KËRKESË

Kërkojmë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, që në bashkëpunim me KRU Bifurkacioni ShA të formoj një grup punues për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhen puset, rezervoaret e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore, të cilat janë asete të KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj.

Me respekt!

Sekretari i KRU Bifurkacioni

Besnik Aliu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 07-104/02-15302/20
Kaçanik, 21.07.2020

Në mbështetje të nenit 12, 17 lidhur me nenin 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 6.2 lidhur me nenin 61.1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut INr. 3588/2008 të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 21 Korrik 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01 NR.104/02-1514/19 TË DATËS 29.01.2019 PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË PARAQITURA TE QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-1514/19 datë 29.01.2019- Për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet e paraqitura të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit nga pika 1 e këtij Vendimi, bëhen të pika 1 dhe të pika 2 si vijon:
 - 2.1. Të Pika 1. Shtohet paragrafi 1.1 me tekstin si vijon:
" Te rastet mortore të kategorisë së Veteranëve të luftës së UÇK-së parashihet financimi shtesë në shumë 175€ (njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) për secilin rast mortor të kësaj kategorie".
 - 2.2. Të pika 2, shtohet paragrafi 2.1. me tekstin si vijon:
"Te rastet mortore të kategorisë së Veteranëve të luftës së UÇK-së përfshihen shërbimet shtesë:
 - 2.1.1 Sigurimi i arkivolit; dhe
 - 2.1.2 Sigurimi i flamurit kombëtar.
3. Pikët tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë propozim të vendimit njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 104/02-1514/19
Kaçanik; 29.01.2019

Në mbështetje të nenit 12, 17 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 6.2 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 Janar 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË
PARAQITURA TË QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, Lejohet financimi i shpenzimeve të varrimit në shumë 175.00€ për secilin rast mortor të paraqitur të qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
2. Financimi në tërësi i shpenzimeve të caktuara të varrimit për të gjitha rastet e paraqitura deri në shumën e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përfshinë këto shërbime:
 1. Lajmërimi (temxhiti),
 2. Pastrimi dhe ruajtja e kufomës në morg (lokacionet ekzistuese në komunën tonë),
 3. Sigurimi i dërrasave,
 4. Sigurimi i mbështjellësit (qefini),
 5. Ceremonia e faljes së kufomës,
 6. Transporti i kufomës brenda territorit të Republikës së Kosovës,
 7. Piramida (mbishkrimi i emrit dhe mbiemrit).
3. Mjetet buxhetore nga pika 2. të këtij Vendimi do të merren nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
4. Me këtë Vendim, qytetarët e Komunës së Kaçanikut, nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë ndaj bashkësive fetare.
5. Bashkësitë fetare nuk mund t'i kushtëzojnë qytetarët e Komunës së Kaçanikut, me pagesën e anëtarësisë, për kryerjen e shërbimeve të cekura në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Çmimet për shërbimet nga pika 2 e këtij Vendimi, raportimi për mjetet e shpenzuara si dhe çështje të tjera të cilat nuk janë potencuar me këtë vendim, do të rregullohen me, marrëveshje të Kryetarit të Komunës dhe Bashkësive fetare, e cila marrëveshje do të jetë pjesë përbërës e këtij Vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim, njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryeshtesi i Kuvendit
Këmal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.350/02-16206/20
Kaçanik, 21.07.2020

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016) si dhe në bazë të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL Nr. 020-332/4 të datës 19.06.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më 21 Korrik 2020, merr këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PARAPRAK 01Nr. 06-350/01-9350/20 I DATËS 27.05.2020 - PËR NDRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

1. Me këtë Vendim, **ANULOHE**T Vendimi Paraprak i Kuvendit të Komunës 01Nr. 06-350/01-9350/20 i datës 27.05.2020 - Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale Nr. 00757-0 në sipërfaqe prej 300 m², arë e klasit të dytë, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917064-00757-0, Zona Kadastrale Nikaj, në vendin e quajtur “Kamenica Li Vogël”, të Azem (Fejzulla) Guri nga fshati Nikaj , pronar -(bashkë posedues me 1/3) së sipërfaqes së përgjithshme 1644m².
2. Anulimi i Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet pas Kërkesë të MAPL të datës 19.06.2020 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjës- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak së i njëjti është në kundërshtim me nenin 11.2 dhe 11.4 lidhur me nenin 10.5 (a) dhe (b) dhe nenin 44.1 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/01.06.2007).
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe organet tjera relevante.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet, Pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/01-9350/20
Kaçanik, 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 6.2 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/01-9350/20 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr.00757-0, me kulturë bujqësore Arë e klasës së 2 (dytë) në Zonën Kadastrale, Kaçanik, sipas kërkesës së Azem Guri (bashkë-posedues me 1/3), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 Maj 2020, mori këtë:


V E N D I M

PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore, të pronës së AZEM GURI nga f. Nikaj.
2. Toka me destinim bujqësor nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet me iu ndërruar destinimi në Parcelën Kadastrale Nr. 00757-0 në sipërfaqe 300m², Bujqësore- Arë e klasës së 2 (dytë) e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-Nr. 70917064-00757-0, Zona Kadastrale Nikaj në vendin e quajtur "Kamenica Li Vogël", sipas kërkesës së Azem (Fejzulla) Guri, pronar- (bashkë-posedues me 1/3) e sipërfaqes së përgjithshme 1644m², sipas numrit të lëndës: 941-9333 të lëshuar nga Zyra Kadastrale me 29.04.2020 bashkangjitur këtij vendimi.
3. Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet " Toka bujqësore", ndërkaq me këtë Vendim i ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore dhe e njëjta bëhet pjesë përkatëse e PZHK.
4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
5. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohej, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli






Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komuna Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Shtiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave
Përmes:	 Bekim Hoxha, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Bekim Hoxha, U.d. Sekretar i Përgjithshëm i MBPZH
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZH
Zyrtarët përgjegjës:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZH
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i rregullt i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.350/02-16206/20 për anulimin e vendimit paraprak 01 Nr.06-350/20 i dt. 27.05.2020 i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) NR.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë (QRK)-NR.06/2020 për

3044/2
27.8

HYKËSË DOKUMENTARIE
KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E BUKTËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
05.08.2020

Numri i Dokumentit	Nr. i Lendës	Shënim	Vlera
020-352/7			

Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020) dhe Departamenti Ligjor i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (28.07.2020) ka pranuar kërkesë për konsultim paraprak ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktit komunal si ne vijim:

Vendimi 01 Nr.350/02-16206/20 për anulimin e vendimit paraprak 01 Nr..06-350/20 i dt. 27.05.2020 i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore .

I miratuar më datë: 21.07.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 28.07.2020

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Vendimi 01 Nr.350/02-16206/20 për anulimin e vendimit paraprak 01 Nr..06-350/20 i dt. 27.05.2020 i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, është në pajtim me Nenin 11, paragrafi 11.2, Nenin 11 paragrafi 11.4 dhe Nenin 44 paragrafi 44.1 i Ligji Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007), në të cilin citohet:

Neni 11, Paragrafi 11.2, Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj.

Neni 11 paragrafi 11.4, Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të fillojë të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër.

Neni 44 paragrafi 44.1 "Deri në nxjerrjen e planit hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të kuvendit komunal"

Arsye tjetër e anulimit të vendimit paraprak është se Komuna e Kaçanikut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal me datën 28 Dhjetor 2010.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

06.Nr. 350/01-9350 /2020

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, nenit 10, paragrafët 10.2 dhe 10.3 të Ligjit nr. 02/L-26, për tokën bujqësore, nenit 8, paragrafi 8.4 të Udhëzimit administrativ nr.41/2006, për ndërrimin e tokës bujqësore, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Kaçanikut, kërkesës, 06.Nr.350/01-9350/20, të dt.30.04.2020, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, drejtori i DUKMM-së bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

I

Me këtë propozim vendim paraparak MIRATOHEM kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe shfrytëzimit actual (sipas fletës poseduese).

II

Sipas pikës I të këtij propozim vendimi paraparak, toka me destinim bujqësore, parcela kadastrale nr.00757-0 me bujqësore-arë e klasës 2, me sipërfaqe prej 1644m², të evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-nr.70917064-00757-0 në pronësi të Azem Guri (bashkëposedim me sipërfaqe prej 1/3), Zona kadastrale Kaçanik, destinohet tokë ndërtimore. Sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela në fjalë parashihet tokë bujqësore.

III

Për zbatimin e këtij vendimi paraparak do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka pranuar kërkesën 06.nr.350/01-9350/20 me date: 30.04.2020 për ndërrim destinimi prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore në sipërfaqe prej 300m².

Ukshin Çallaku

Drejtori i DUKMM




 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KACANIKU
Drejtorati / Njesia Urbanizëm, Kadastër e Mjedisë		Data <u>29.04.2020</u> (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:			Mos shkruani në Pranuar nga: Numri i protokollit: <u>66-350/01-9350/20</u> Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri <u>AZEM GURU</u>	Lloji dhe numri i dokumentit identifikues		
Data e lindjes <u>29.04.1969</u> (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit <u>NIKAJ - KACANIK</u> (numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)		
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil <u>044 493 949</u>	E-mail adresa	
(Empty space for additional contact information)			

2 Selektu llojin:	
Kërkesë ☒	Ankesë ☐

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:
<u>Kërkoj nga DUKMM lirin e mferimit te</u> <u>destinimit per 300m² ne parcelen 157-0,</u> <u>zona kadastrale NIKAJ.</u>

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi	 (Nënshkrimi)
Unë <u>Azem Guri</u> vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. (Emri i plotë i aplikuesit)	

*** Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRATVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917064-00757-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 941-9333
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 29.04.2020 - 10:01
Komuna / Opština / Municipality: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone: NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Superfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Ops Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917064-00757-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatno imovina Privately owned Land		1644			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësi të adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KAMENICA L.I VOGEL/KAMENICA L.I VOGEL		KAMENICA L.I VOGEL		

A.2 LLOJI I SHFYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëqesore/Poljoprivredno/ Agriculture	Arb/Njive/Arable	Are E Klases 2/Njive 2 Klase/2nd Class Arable Land	1644

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personat Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësihtë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Perskribimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Bashkë Posedim / Sudržavina / co-possessor	GURI XHEMAIL (FEJZULLA)	1004565416	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ /			1/3		20.01.2015
Bashkë Posedim / Sudržavina / co-possessor	GURI AZEM (FEJZULLA)	1005393392	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ /			1/3		20.01.2015
Bashkë Posedim / Sudržavina / co-possessor	GURI XHEVAHIR (FEJZULLA)	2030804107	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ /			1/3		20.01.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

HYRËSE-ULAZNA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA-KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date 17.06.2020

Organizata	Nr. i Lëndës	Shënime	Vlera
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	020-35213		

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komuna	
Përmes:	Besim Mustafa, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Bekim Illoxa, U.d. Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR	
Nga:	Isak Rudaku, U.d. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Zyrtarët përgjegjës:	Shyhrete Bunjaku, Udhëheqëse e Divizionit për zbatim të legjislacionit	16.06.2020
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Vlerësimi i rregullt i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.06-350/01-9350/20 paraparak i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore	

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) NR.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë (QRK)-NR.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020) dhe Departamenti Ligjor i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

(05.06.2020) ka pranuar kërkesë për konsultim paraprak ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktit komunal si ne vijim:

Vendimi Nr.06-350/01-9350/20 paraprak i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore .

I miratuar më datë: 27.05.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.06.2020

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Vendimi paraprak i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore Nr.06-350/01-9350/20, bashkëpronarë i 1/3 e Azem Guri nga fshati Nikaj, Komuna Kaçanik me numër të Parcelës kadastrale Nr.00757-0 në sipërfaqe prej 300m², arë e klasë së dytë sipas Fletës poseduese P.Nr.7091064-0064-00757-0 ZK Nikaj në vendin e quajtur Kamenica e Vogël me sipërfaqe të përgjithshme të parcelës 00757-0 është 1644m² me numër të lëndës 941-9333 të datës 29.04.2020 sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi, është tokë bujqësore me Vendim Nr.06-350/01-9350/20 paraprak i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat kadastrale Nr.00757-0 me sipërfaqe 300m² është në kundërshtim me Nenin 11, paragrafi 11.2, Nenin 11 paragrafi 11.4 dhe Nenin 44 paragrafi 44.1 i Ligji Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007), në të cilin citohet:

Neni 11. Paragrafi 11.2. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj.

Neni 11 paragrafi 11.4. Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër.

Neni 44 paragrafi 44.1 "Deri në nxjerrjen e planit hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të kuvendit komunal"

Arsyet e supozuara të shkeljes është sepse Komuna e Kaçanikut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal me datën 28 Dhjetor 2010.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/02-15987/20
Kaçanik, 21.07.2020

Në bazë të nenit 12 .2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 21 Korrik 2020, miratoj Deklaratë për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si vijon:

D E K L A R A T Ë

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Slllobodan Millosheviqit, forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.
2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.
3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.
4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi.
5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur për pafajësinë e tyre.

6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të perealizueshme, tendencat për ta kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje për ta etiketuar UÇK-në si agresore;

7. E vërteta për historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë për t'i barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.

8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike për të ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAÇANIK		
Data	16.07.20	Vendi
Org.	Nunri	Shtojcë
01	60/02-1787	-1


Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës Kaçanik i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e Deklaratës për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës:

DEKLARATË





1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Slllobodan Millosheviqit, forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.
2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.
3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.
4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi.
5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur për pafajësinë e tyre.
6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të perealizueshme, tendencat për ta kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje për ta etiketuar UÇK-në si agresore;
7. E vërteta për historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë për t'i barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike për të ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së

Shefi i grupit, Nexhat Loku



Lista e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

1.Kemal Mërseli	
2.Nexhat Loku	
3.Hamid Guri	
4.Ahmet Luma	
5.Kadri Krivenjeva	
6.Besim Vishi	
7.Sali Malsiu	
8.Lirije Shurdhani – Dema	
9.Pranverë Loku-Zharku	
10.Lirije Luta	
11.Vlora Dallosi	